



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## BASHKIA KUÇOVË

Data \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / 2024

### PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

#### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

#### **OBJEKTI I PROKURIMIT :**

“Rikualifikimi i rrugëve Mersin Dyrmo, Nënstacioni, Lord Bajron, Riza Alizoti”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

**Kodi 45233120-6** (punime ndërtimi për rrugë).

#### **VLERA E FONDIT LIMIT :**

**23 428 278,11** (njëzetë e tre milion e katëqind e njëzetë e tetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e tetë presje njëmbëdhjetë) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kuçovë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përbajtjen si më poshtë :

## **KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë :

a. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;*

b. *Formulari përbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 3....*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2023 dhe për vitin 2024 duke mbajtur në konsideratë dhe përcaktimet e Ligjit Nr 9632, datë 31.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, pranë njësive vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e ti sipas QKB-së.

*Për përbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përbledhës të vetëdeklarimit.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

### **Për Taksat Lokale**

Në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nen 9 përcaktohet se :

Në taksat vendore përfshihen :

1. Taksa vendore mbi biznesin e vogël.
2. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat dhe taksa mbi tokën bujqësore.
3. Taksa e fjetjes në hotel.
4. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.
5. Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.
6. Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve.
7. Taksa për zënien e hapësirave publike.

8. Taksa e tabelës.

9. Taksa të përkohshme.

Në nenin 14 po këtu, përcaktohet se : “1. Taksa paguhet në katër këste të barabarta. Kësti i parë paguhet brenda datës 20 prill. Kësti i dytë jo më vonë se data 20 korrik, kësti i tretë jo më vonë se data 20 tetor dhe kësti i fundit jo më vonë se data 20 janar e vitit të ardhshëm fiscal”.

**Bazuar mbi sa më sipër kërkesa e autoritetit kontraktor për pagesën e taksave lokale për vitin 2023 dhe 2024 është në përputhje me ligjin 9632 datë 30.10.2006 ”Për sistemin e taksave vendore”.**

## **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kritereve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*)

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron minimale vjetore për tre vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 80% e fondit limit të kontratës që prokurohet.

(*Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor*).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë :

Autoriteti kontraktor, në përcaktimin e vlerës së xhiros minimale vjetore (dhe konkretisht jo më pak se 80% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet) ka mbajtur në konsideratë nenin 43 pika 2 gërmë b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku shprehimit thotë se :

Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare .

---

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

- a) dyfishin e vlerës së përllogariturtë kontratës ose lotit<sup>1</sup>, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;
  - b) **vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;**
  - c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulencë”.
- 

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros qëmund të kërkohet, autoritetet/entet kontrakte duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatile": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatile brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji".

**2.2.2** Operatorët ekonomikë ofertues duhet të japid informacione në bilancet e tyre vjetore për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistikës të miratuar", i ndryshuar, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivit dhe pasivit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbrushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.

---

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuaara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatile: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatushme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatile brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Eksperitzen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpala publikim të tyre, nga ekspertri kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standartet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej **50 milionë lekësh**; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej **100 milionë lekësh**; iii) ka, mesatarisht, **30 të punësuar gjatë periudhës kontabël**".

## 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

### 2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njofitimit të kontratës, ose
- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 180 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjeter, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Për të vërtetuar përvojën e suksesshme në ekzekutimin e një kontrate të ngashme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtëm :

- Për kontrata për punë publike të realizuar me institucione shtetërore kërkohen:

- Kontraten/at e Sipërmarrjes,*
- Situacion përfundimtare të objektit,*
- Formular Vlerësimi nga Investitori sipas Shtojcës përkatëse,*
- Akt Kolaudimi*
- Faturat tatimore*
- Certifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/ose përfundimtar*

- Për kontrata për punë publike është realizuar me subjekte private kërkohen:

- Kontraten/at e Sipërmarrjes,*
- Situacion përfundimtare të objektit,*
- Formular Vlerësimi nga Investitori sipas Shtojcës përkatëse.*
- Akti i Kolaudimit*
- Faturat tatimore,*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngashme të jenë jo më e vogël se **40 %** të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël **180%** të vlerës së fondit limit për punët totale të

ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

---

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

---

**2.3.2.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme :

### **PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI**

- 1.** NP- 1 A Punime gërmimi në tokë
- 2.** NP- 4 A Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale

### **PUNIME SPECIALE NDËRTIMI**

- 1.** NS - 18 A Punime topogeodezike

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktures dhe Energjise, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në Nr.42, datë 16.01.2008).

## **Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin39, pika 6/a, të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimitari ndërtimi”.

Kategoritë e kërkuar janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

### **PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI**

#### **N.P. 1 (Punime gërmimi në tokë)**

Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetele, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Duke analizuar preventivin e punimeve, liçensa e mësipërme përkon me punimet si 3.87/b Gërmim dhei me eskavator me goma  $0.25 \text{ m}^3$  në kanale gjerësi  $>2 \text{ m}$  tok zak, kategoria III me shk në tokë në sasinë  $88 \text{ m}^3$ , si dhe 3.89/a Gërmim dhei me eskavator me goma  $0.25 \text{ m}^3$  në kanale gjerësi deri në  $2 \text{ m}$  tok zak, kategoria III me shk në mjet në sasinë  $50 \text{ m}^3$ .

**NP- 4 A** (Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar **rrugët**, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet nën nivele dhe në lartësi, parkimet, **punime të mureve mbajtëse**, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tranvai, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrale dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të paranderur, parafabrikat ose të prodhuar në objekt.

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi “goma”, “hekur”, “zona”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo vepre lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore.

Duke parë dhe vetë objektin e prokurimit i cili është “Rikualifikimi i rrugëve Mersin Dyrmo, Nënstacionit, Lord Bajron, Riza Alizoti” kjo kategori ndërtimi përkon dhe është në përputhje dhe vëllim të plotë me investimin që do të kryhet (e cila përshtatet me çdo zë të preventivit të punimeve). Bazuar mbi objektin e prokurimit, qëllimi kryesor i autoritetit kontraktor është shtrimi i disa rrugëve në lagjen 1 Maj, duke i siguruar banorëve të zonës kushte më të mira jetesë. Bazuar dhe nga preventive i punimeve ku përfshin punë të tilla si psh, 3.207/1 shtresë çakëlli  $t=10\text{cm}$  e përhapur e ngeshur me makineri në sasinë  $6708 \text{ m}^2$ , 3.212/b shtresë stabilizanti  $10\text{cm}$  në sasinë  $8365 \text{ m}^2$ , 3.233/4 shtresë asfaltobetoni me zall lavatriçe  $7\text{cm}$  me makineri në sasinë  $6708 \text{ m}^2$  etj, të cilat janë në përputhje me licencën e mësipërme të kërkuar nga autoriteti kontraktor.

## PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

**NS - 18 A** ( Punime Topogjeodezike konsiderohet zbatimi i rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjéodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh )

Referuar natyrës së punimeve të mësipërme për këto të fundit, shfaqet e nevojshme disponueshmëria e kategorive të licencës për zbatim NS 18 - A, si punime të cilat përfshihen në grupin e punimeve parashikuar në lidhjen nr.3 të Vendimit 17 nr. 42, datë 16.01.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Ku kjo kategori kër kohet për çdo punë ndërtimi ku ka shtrim rrugësh, rikonstrukSIONE ose ndërtim baneshash, punime ndërtimi, gërmim kanali etj sepse ai merret me rilevimit e tokës, kuatot, profile tërhero dhe gjatësore, piketimet.

Në Lidhjen 4 “Klasifikimi paraprak i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi” të VKM-së nr. 42, është vënë dhe kategoria A për të gjitha kategoritë e kërkuar sipas nivelit nga 0 deri në 20 milion lekë .

**2.3.3.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë :

- |                       |         |
|-----------------------|---------|
| 1) Inxhinier Ndërtimi | 1 (një) |
| 2) Inxhinier Topograf | 1 (një) |

Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në liçensën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesën e shoqërisë *për të paktën muajin e fundit*, duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës .

Për të dëshmuar përbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë :

*Për secilin pjestar te stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë kontrate pune e vlefshme, diplomë, librezë pune dhe CV, (Drejtuesit teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi)*

***Për përbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përbledhës të vetëdeklarimit.***

Në rastin konkret synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë staf të kualifikuar teknik për kryerjen e punimeve objekt kontrate.

Në nenin 8 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” parashikohet se “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas apo të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore.” Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane. Me materiale dhe produkte ndërtimi kuptohet çdo produkt i prodhuar për t'u përfshirë në mënyrë të përhershme në punimet e ndërtimit.”

Sa më sipër, në interpretim të dispozitave të mësipërme, zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga personat të pajisur me licencë të cilët njëherazi mbajnë përgjegjësi për realizimin e punimeve në përputhje me kushtet e kërkua nga ana e autoritetit kontraktor. Lidhur me disponueshmërinë e Inxhinierëve të mësipërm, njësia e prokurimit gjykon se për sa kohë që autoriteti kontraktor në preventivin e punimeve ka parashikuar punime të një natyre në të cilën shfaqet e nevojshme disponueshmëria i një Inxhinier ndërtimi, Hidroteknik, Elektrik, Mjedis, Gjeolog si dhe Topograf parë kjo në raport edhe me pikat dhe kategoritë përkatëse të licencës së kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor, dhe referuar volumeve të punimeve të parashikuara në preventivin dhe në projektin përkatës, kriteri i mësipërm është në përputhje dhe proporcion me volumin e kontratës, si dhe në raport me kohëzgjatjen e zbatimit të punimeve të parashikuar, vlerën dhe natyrën e saj, është një kërkesë në përpjestim me natyrën dhe objektin e punimeve dhe nuk shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme .

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates,

*relacionin teknik dhe zérat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt eshtë e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit eshtë përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.*

## ➤ Inxhinier Ndërtimi                  1 (një)

Nga zérat e preventivit dhe natyra e objektit të prokurimit dhe në zbatim të VKM 629 datë 13.05.2015 “Për miratimin e manualeve teknikë të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” janë përcaktur numri i punonjësve dhe stafi i kualifikuar me licencë ose dëshmi të lëshuara nga autoritet e përcaktuara me ligj. Kërkesa për një inxh. Ndërtimi që të jenë në licencën e shoqërisë eshtë vendosur në zbatim të Kodit të Punës, kohëzgjatja javore e punës 48 orë për një periudhë të gjatë pune (afati i realizimit të punimeve të kontratës eshtë 4 muaj, në zbatim të VKM nr.42 datë 16.01.2008 Për Miratimin e Rregullores për Kriteret dhe Procedurat e Dhënes së Licencave Profesionale të Zbatimit, Klasifikimit dhe Disiplinimit të Subjekteve Juridike, që Ushtrojnë Veprimtari Ndërtimi”, pika II :c) Autoritetet kontraktore, në përcaktimin e grafikëve dhe afateve për përfundimin e punimeve të ndërtimit, në dokumentet e tenderit të prokurimit dhe në kontratën e zbatimit të veprave publike, ndërtimore, detyrohen të llogarisin kryerjen e punimeve, për periudhën 4 mujore, për ndërtimin e objekteve .

Specialiteti i inxhinierëve të ndërtimit eshtë vendosur në zbatim të VKM nr. 42 datë 16.01.2008 Kreu IV “Drejtuesi Teknik i shoqërisë dhe pa pajtueshmëria me këtë detyrë ”.

Synimi bazë i autoritetit kontraktor eshtë vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë staf të kualifikuar teknik (inxhinier ndërtimi të cilët janë njëherazi dhe drejtues teknik) për kryerjen e punimeve në përputhje me kohëzgjatjen e parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit dhe njëherazi në përputhje me turnet e parashikuar nga akti nënligjor në zbatim të ligjit. Në nenin 8 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Per Kontrollin Dhe Disiplinimin E Punimeve Te Ndertimit” parashikohet se “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas apo të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore.” Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe eshtë i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Me materiale dhe produkte ndërtimi kuptohet çdo produkt i prodhuar për t'u përfshirë në mënyrë të përhershme në punimet e ndërtimit.”

Duke analizuar preventivin e punimeve , dhe parë objektin e prokurimit i cili eshtë “Rikualifikimi i rrugëve Mersin Dyrmo, Nënstacionit, Lord Bajron, Riza Alizoti” dhe zérat

përkatës në preventiv ku shumica prej tyre janë punë ndërtimi, del i nevojshëm që operatori ekonomik fitues duhet të disponoj një inxhinier ndërtimi.

### ➤ Inxhinier Topograf 1 (një)

Inxhinier topograf kërkohet për çdo punë ndërtimi ku ka shtrim rrugësh, rikonstruksione ose ndërtim baneshash, punime ndërtimi, gjermim kanali etj sepse ai merret me rilevimit e tokës, kuatot, profile tërhero dhe gjatësore, piketimet etj. Prania e topografit është e domosdoshme në terren për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë duke i dhënë garanci autoritetit kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses.

**2.3.4** Operatorët ekonomik ofertues duhet të disponojnë punonjës të specializuar/të kualifikuar, për të paktën muajit e fundit si staf teknik punonjësit si më poshtë :

NR	EMËRTIMI	PUNONJËS
1	Teknik ndërtimi	1 (një)
2	Asfaltoshtrues	2 (dy)
3	Karpentier	2 (dy)
4	Teknik topograf	1 (një)
5	Eskavatorist	2 (dy)
6	Buldozerist	1 (një)
7	Automakinist	2 (dy)
	Totali 11 (njëmbëdhjetë)	

*Për përbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë ofertues duhet të vetëdeklorojnë disponimin e punonjësve të mësipërm në përputhje me shtojcën 8 .*

**Përpara lidhjes së kontratës për të dëshmuar përbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë :**

Dëshmi kualifikimit të sigurimit teknik të cilat të janë të lëshuara nga shoqëri të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, *ose certifikata ekuivalente të tyre (të vlefshme)*, kontrate pune e vlefshme, çertifikatat përkatëse si edhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë për 3 (tre) muajt e fundit.

Për manovratorët të paraqitet kontrata e punës dhe dëshmia e aftësisë profesionale lëshuar nga DPSHTRR.

Dokument (dëshmi kualifikimi profesional) që të vërtetojë kualifikimin profesional të këruar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimore dhe tokë, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre)

Në rastin kur mjetet e këruar më poshtë në pikën **2.3.7** janë me qera nuk është kusht që shoferët të janë në listpajesën e shoqërisë, ata do të lejohen të plotësohen nga ofertuesit **edhe nëpërmjet kontraktimit për kët objekt prokurimi.**

(Shënim: listoni dokumentacionin provues që dëshmon disponimin e stafit kryesor, mbështetës dhe të specializuar / kualifikuar të këruar, dhe nëse është rasti kërkesat për licencat profesionale individuale, apo certifikimet / kualifikimet që duhet të disponojnë anëtarët e stafit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, si dhe insitucionin që lëshon këto licenca apo certifikime / kualifikime).

**Argumentimi në lidhje me pikën 2.3.4 .** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Njësia e prokurimit sqaron se të gjithë punonjësit e këruar si më sipër me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik *apo certifikata ekuivalente të tyre*, përkojnë me punimet sipas preventivit të publikuar në SPE, dhe konkretisht :

### **Për asfaltoshkrues 2 (dy) persona**

Njësia e prokurimit gjykon se punimet e parashikuara në preventivin e kontratës objekt prokurimi, ku parashikohet shtrimi i shtresës së asfaltobetonit me makineri autobitumatriçë dhe asfaltosħtruese, garanton autoritetit kontraktor që ofertuesit duhet të disponojnë të paktën dy

drejtues për makineri shtrimi asfalti për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë, për sa kohë disponueshmëria e tyre lidhet drejtëpërdrejtë me manovrimin e mjeteve të mësipërm.

**Për Eskavatorist** të pajisur me dëshmi të aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe të punimeve në tokë si dhe **automakinist** dhe buldozerist të pajisur me dëshmi të drejimit të lëshuar nga DPSHTRR,

Njësia e prokurimit gjykon se punimet e parashikuara në preventivin e kontratës objekt prokurimi, ku parashikohet shtrimi i rrugës me shtresë çakëlli në sasinë 6708 m<sup>2</sup> dhe shtresë stabilizanti në sasinë 8365 m<sup>2</sup>, garanton autoritetit kontraktor që ofertuesit duhet të disponojnë një drejtues për makineri të rënda dhe dy shoferë për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë, për sa kohë disponueshmëria e tij lidhet drejtëpërdrejtë me manovrimin e mjeteve si Kamiona vetshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 15 ton për transportimin e mallrave të sipër cituar, Grejder, fadromë, eskavator si dhe Rrul me peshë deri në 10 ton 2 copë për ngjeshjen dhe sistemimin e çakullit dhe stabilizantit.

Akoma më tej, kriteri i mësipërm është lënë i hapur për tu plotësuar nga ofertuesit për sa kohë disponimi i tyre lejohet të përbushet edhe nëpërmjet nënkontraktimin në rastet kur mjetet e kërkuar më poshtë sipas pikës 2.3.7 janë me qera.

**Për teknik ndërtimi** 1 (një) person dhe **Karpentier** 2 (dy) persona, nevojitet prezenca e tyre në kantier për “Rikualifikimi i rrugëve Mersin Dyrmo, Nënstacionit, Lord Bajron, Riza Alizoti” duke garantuar autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses si punime për sistemimin e shtresës së çakullit dhe stabilizantit në gjithë gjatësinë e rrugës përpara ngjeshjes së saj me makineri, për zërat ndërtim kasonete në tokë mesatare për punimet e mure buto betoni C 12/15 si dhe për themel e xokol butobetoni C 16/20

Në lidhje me **Teknik Topograf** 1 (një) person, nevojitet prezenca e tij në kantier për të kryer rilevimet e tokës dhe piketimit në lidhje me rikualifikimin e disa rrugëve në lagjen 1 Maj duke garantuar autoritetin kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses nën udheheqjen e inxhinierit topograf.

**2.3.5** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 13 (trembëdhjetë) persona *për të paktën muajin e fundit.*

Për përbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë ofertues duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për tre muajt e fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në formularin përbledhës të vetëdekclarimit, sipas shtojcës nr.8 .

Ndërsa operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë :

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit, për periudhen **si më sipër**.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **si më sipër**.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit,që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përbushur kontratën.

Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kritereve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Referuar legjislacionit në fuqi, është përcaktuar se autoriteti kontraktues kërkon dëshmi për fuqinë punëtore me qëllim që të garantohet për realizimin me sukses të kontratës.

Si dhe referuar përmasave të kontratës që do të do të prokurohet, specifikimeve teknike, fondit limit, afatit të zbatimit të saj, si dhe kohëzgjatjes së parashikuar për realizimin e punimeve gjithësej 4 (katër) muaj, njësia e prokurimit vlerëson se numri i punonjësve të kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor në rastin konkret, garantohet për zbatimin e kontratës me sukses duke krijuar besueshmerinë dhe qëndrueshmëri të punonjësve tek operatorët ekonomik, si dhe duke mos sjellë vonesa në zbatimin e saj.

Lidhur me përcaktimin e numrit të punonjësve, njësia e prokurimit ka mbajtur në konsideratë Rekomandimin e APP Nr 4916/2 Prot të datë 14.07.2022, pika 3, ku përcaktohet se autoritetet kontraktore duhet të hartojnë kërkeshat e veçanta të kualifikimit në përputhje me nenet 77 të LPP

dhe 78 të VKM, si dhe legjislacionit të fushës përkatës, duke argumentuar dmosdoshmérinë e tyre në çdo rast.

Bazuar mbi rekomandimin e APP, njësia e prokurimit ka hartuar analizën teknike ku parashikohet fuqia punëtore duke u bazuar në preventivin e punimeve si dhe afateve kohore të parashikuar në grafikun e punimeve dhe mbi bazën e analizave përkatëse ka përcaktuar numrin e saktë të punonjësve që nevojiten për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

**2.3.6** Operatorët ekonomik ofertues duhet të jenë të certifikuar sipas standardeve ISO të leshuara nga organizmat e vleresimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njojur nga Republika e Shqiperisë, dhe konkretisht :

- ISO 9001:2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë e vlefshme ), *ose ekuivalent*
- ISO 14001-2015 (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor e vlefshme), *ose ekuivalent*
- ISO 45001-2018 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë e vlefshme), *ose ekuivalent.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Për vetë natyrën e veçantë dhe delikate, dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet si dhe afatit për zbatimin e saj.

Kjo certifikatë lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pranohet edhe certifikata ekuivalente të tyre dhe i shërbijnë autoritetit kontraktor për njojen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përm bushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmérinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuarat të cilësisë, përfshirë edhe standardin për menaxhimin e mjedisit për sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtëpërdrejtë në mjedis.

ISO ( Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit ) është një organizatë me anëtarësi e pavarur, jo-qeveritare dhe zhvilluesi më i madh në botë i Standardeve Ndërkombëtare, nga 163 vende të botës. ISO publikon më shumë se 19500 Standarde Ndërkombëtare, të cilat mbulojnë pothuajse çdo fushë industrije, nga teknologjia te siguria ushqimore, bujqësia e shëndeti. Në nivel botëror shoqëritë ndjekin adoptimin e standardeve të cilësise me qëllim që të jenë të respektuar nga

klientet e autoritetet shtetërore dhe të ndërtojnë bashkëpunim të qendrueshëm me avantazhe reciproke.

➤ **ISO 9001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) ose ekuivalent**

Për implementimin e Sistemit të Manaxhimit të cilësisë, është standarti më i njohur që është publikuar ndonjëherë në nivel ndërkombëtar. Ai përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të çertifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilën AK kërkon ta kryejë me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, preventivin dhe vlerën e saj, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij që të kërkoj çertifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, që përpos punimeve që do të kryhen nga operatorët ekonomik ofertues, këto punime të kryhen me cilësi sipas çertifikatës ISO të mësipërme .

➤ **ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit te ambjentit” e vlefshme, ose ekuivalent**

Ky çertifikim shërben në lidhje me sistemet e menaxhimit mjedisor, me anë të së cilës garantohen mundësítë e identifikimit, vlerësimi dhe menaxhimi të aspekteve mjedisore të një subjekti me synim parandalimin e dëmtimit të mjedisit, respektimin e legjislacionit vendas në lidhje me mjedisin dhe ruajtjen e burimeve natyrore. Gjithashtu, ky çertifikim fokusohet në njohjen e të gjitha aspekteve mjedisore dhe menaxhimin efektiv të pasojave të aktivitetit të subjektit, duke bërë të mundur të përmirësohet ndikimi i veprimitarise së përgjithshme të subjektit në aspektin mjedisor .

Kjo çertifikat është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore. Referuar objektit të prokurimit në rastin konkret, njësia e prokurimit e ka parë të nevojshme që shoqëritë të jenë të çertifikuara nga organizata ndërkombëtare të cilat garantojnë një nivel të pranuar të menaxhimit të mjedisit sa kohë që veprimitaria e tyre ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi të, duke kryer një proces riaftësimi më pas të ambjentit përreth ku do të kryhet investimi .

➤ **ISO 45001-2018 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë e vlefshme) ose ekuivalentet e tyre**

Është dokumenti i njohur në mënyrë zyrtare në nivel ndërkombëtar që përcakton kërkesat për një sistem manaxhimi të shëndetit dhe sigurimit në punë .

Kjo çertifikatë garanton sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve që marrin pjesë gjatë një procesi prodhimi apo kryerjes së një veprimitarie apo pune publike e cila vë apo mund të vërë në

rezik shëndetin dhe jetën e punonjësve. Është e lidhur ngushtë dhe në përpjestim me objektin e kontratës, sipas parashikimeve të LPP.

Autoriteti kontraktor përpos punimeve që do të kryejë, kërkon që këto punime ti zhvillojë në përputhje dhe garanci të plotë me sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve.

### **2.3.7 Operatorët ekonomik ofertues për realizimin me sukses të kontratës, duhet të disponojnë**

Nr	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Kamiona vetshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 15 ton	3 copë	Pronësi ose me qera
2	Kamionçinë me kapacitet mbajtës 3.5 - 5 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
3	Eskavator me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
4	Eskavator me zinxhirë	1 copë	Pronësi ose me qera
5	RTV Transportier për mjete të rënda	1 copë	Pronësi ose me qera
6	Fadromë me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
7	Asfaltoshtruese	1 copë	Pronësi ose me qera
8	Autobitumatriçe	1 copë	Pronësi ose me qera
9	Grejder	1 copë	Pronësi ose me qera
10	Depozitë uji	1 copë	Pronësi ose me qera
11	Rrul me peshë deri në 15 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
12	Pompë betoni	1 copë	Pronësi ose me qera

mjetet dhe pajisjet teknike si më mëposhtme :

*Për përbushjen e kesaj pikës, operatorët ekonomikë ofertues duhet të vetëdeklojnë disponimin e punonjësve të mësipërm në përputhje me shtojcën 8.*

- a) Për mjetet me rrrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikatën e kontrollit teknik si dhe çertifikatën e transportit të mallrave (të vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme) si dhe taksat vjetore.
- b) Për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij ( leje qarkullimi ), çertifikatën e kontrollit teknik si dhe çertifikatën e transportit të mallrave (të vlefshme), siguracionin e mjetit, (të vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse notariale të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

*Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*

- c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira te tij.

- d) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës përkatëse. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).
- e) Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara më sipër do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontrate. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak për skualifikim. Autoriteti Kontraktor gjzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmerine e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës .

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përbushur konratën.

Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar ligjvënësi i jep të drejtën autoritetit kontraktor të kërkojë nga ana e operatorëve ekonomik dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike. Njësia e prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatës në lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi. Çdo mjet i përcaktuar sa më sipër është kërkuar në funksion të kryerjes së zërave specifike të punimeve të ndërtimit dhe preventivit të hartuar nga Drejtoria e Urbanistikës Bashkia Kuçovë, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varësi të volumeve të punimeve. Për realizimin e kontratës me sukses dhe në kohë autoriteti kontraktor kërkon garanci nga operatorët ekonomik ofertues të cilët duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e mësipërme, gjithçka në funksion të zbatimit të kontratës.

Duke parë volume e punimeve, afatin për realizimin e saj, vlerën e kontratës, relacionin teknik është e nevojshme që operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se disponojnë mjetet e mësipërme për realizimin me sukses dhe në kohë të objektit të prokurimit .

**Analizë të detajuar në lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që kërkohen nga autoriteti kontraktor :**

- Në lidhje me kamion vetëshkarkues 3 copë me kapacitet minimumi 15 ton dhe 2 copë kamioncine me kapacitet mbajtës min 3.5-5 ton njësia e prokurimit është bazuar në preventivin e punimeve duke analizuar proceset e punës që do të zhvillohen të cilat janë të domosdoshëm prania e mjeteve të mësipërme për transportimin e të gjitha materialeve të ndërtimit pranë kantierit dhe më konkretisht, për zërat shtresë çakëlli mbeturina kave  $t=0$ cm në sasinë  $6708\text{ m}^2$ , 3.212/b shtresë stabilizanti 10cm në sasinë  $8365\text{ m}^2$ , disponueshmëria e mjeteve të sipërcit të garanton AK për zbatimin e kontratës me sukses.

Nga proceset e punës të listuar si më sipër, si dhe duke u bazuar në grafikun e punimeve të ndërtimit, njësia e prokurimit gjykon se ka parashikuar një numër minimal mjetesh me qëllim zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

- Në lidhje me Rrul me peshë deri në 15 ton 2 copë, Grejder 1 copë.  
Njësia e prokurimit sqaron se mjeti Grejder është i domosdoshme për nivelimin e çakëllin në sasinë  $6708\text{ m}^2$ , kurse mjeti Rrul peshë deri në 15 ton është i nevojshëm për ngjeshjen e stabilizantit dhe granilit në sasinë  $8365\text{ m}^2$ .  
Disponimi i mjeteve të mësipërm nga ana e ofertuesve garanton autoritetin kotraktor që zbatimi i punimeve të kryhet në kohë dhe në përputhje me grafikun e punimeve.
- Në lidhje me Asfaltoshtruese 1 copë, dhe Autobitumatrice 1 copë, njësia e prokurimit është bazuar në preventivin e punimeve duke analizuar proceset e punës që do të zhvillohen të cilat janë të domosdoshëm prania e mjeteve të mësipërme për zërat e preventivit dhe më konkretisht :  
Për zerin 3.233/4 Shtresë asfaltobetoni me zall lavatriçe, 7 cm me makineri.  
Autobitumatriçe është e nevojshme për hedhjen e prajmerit (që hap lëngun para shtrimit të asfaltit).  
Asfaltoshtruesja është e nevojshme për shtrimin e asfaltit në sasinë  $6708\text{ m}^2$ .  
Disponimi i mjeteve të mësipërm nga ana e ofertuesve garanton autoritetin kotraktor që zbatimi i punimeve të kryhet në kohë dhe në përputhje me grafikun dhe preventivin e punimeve.
- Lidhur me mjetin eskavator me goma dhe zinxhirë, njësia e prokurimit gjykon se për sa kohë disponueshmëria e tyre lidhet drejtë për drejtë me zbatimin e punimeve të kontratës dhe konkretisht për zërat gërmim dhe sistemimin e rrugëve, kërkesa e mësipërme është në përputhje me objektin e kontratës.
- Në lidhje me mjetin RTV Transportier për mjete të rënda, njësia e prokurimit sqaron se është i nevojshëm për transportimin e mjeteve me zinxhira pranë kantierit të ndërtimit.

### **2.3.8 Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të disponojnë :**

Nr	Emërtimi	Sasia	Gjendja
1	Implant për prodhimin e asfaltit me leje mjedisore të vlefshme	1 copë	Pronësi, me qira ose kontratë furnizimi
2	Nyje inertesh e pajisur me leje mjedisore të vlefshme	1 copë	Pronësi, me qira ose kontratë furnizimi

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kerkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përbushur konratën.

Referuar frysës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zoterojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të konratës. Në varësi të konratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkosat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Bazuar dhe në preventivin e punimeve, specifikimeve tekinke dhe relacionit teknik, kërkesa e autoritetit kontraktor për disponimin nga ana e operatorëve ekonomikë ofertues të 1 (një) Implant për prodhimin e asfaltit dhe nyje inertesh, në vetvete nuk është një kriter diskriminues dhe i pamundur për tu përbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përbushje me sukses të konratës. Në varësi të konratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkosat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në rastin konkret është në të drejtën e autoritetit të kërkojë garanci lidhur me mundësitë e operatorëve ekonomik për sigurimin e lëndës bazë dhe materialeve që do të përdoren për realizimin e objektit, përsa kohë lejohet provueshmëria e disponimit nëpërmjet

edhe kontratave të furnizimit sikurse autoriteti kontraktor ka përcaktuar në DST, duke e lenë të hapur përbushjen e këtij kriteri në respekt të plotë të ligjit të prokurimit publik, duke rritur eficencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore duke nxitur njëkohësisht pjesëmarrijen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik .

*Në preventin e punimeve, autoriteti kontraktor ka parashikuar punime si 3.233/4 Shtresë asfaltobetoni me zall lavatriçe 7 cm me makineri në sasinë 6708 m<sup>2</sup>. Si dhe shtresë çakëlli në sasinë 6708 m<sup>2</sup> dhe shtresë stabilizanti në sasinë 8365 m<sup>2</sup>,*

Duke pare volume e mëdha të punës që do të kryhen, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij të kërkojë garanci nga ofertuesit për përbushjen me sukses të çdo zëri të preventivit të punimeve.

*Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”.*

### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuarçdokërsë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tillë duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

## **NJËSIA E PROKURIMIT**